



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2022 – Numri: 106

Tiranë – E hënë, 18 Korrik 2022

PËRMBAJTJA

Vendim Këshillit të Ministrave
nr. 424, datë 22.6.2022

Për miratimin e Deklaratës Hapëse të Republikës së Shqipërisë, Pozicioni i
Përgjithshëm, në kuadër të Konferencës së Parë Ndërqeveritare për
Anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian.....

Faqe

13083

**VENDIM**

Nr. 424, datë 22.6.2022

**PËR MIRATIMIN E DEKLARATËS
HAPËSE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË, POZICIONI I
PËRGJITHSHËM, NË KUADËR TË
KONFERENCËS SË PARË
NDËRQEVERITARE PËR
ANËTARËSIMIN E REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË NË BASHKIMIN
EVROPIAN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe në vijim të pikës 7, të kreut III, të vendimit nr. 749, datë 19.12.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e strukturës shtetërore, përgjegjëse për zhvillimin e negociatave dhe lidhjen e traktatit të aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e Deklaratës Hapëse të Republikës së Shqipërisë, Pozicioni i Përgjithshëm, në kuadër të Konferencës së Parë Ndërqeveritare për Anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Arben Ahmetaj

**KONFERENCA E PARË
NDËRQEVERITARE PËR
ANËTARËSIMIN E REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË NË BASHKIMIN
EVROPIAN
DEKLARATA HAPËSE E
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,
POZICIONI I PËRGJITHSHËM**

Vlerësime të përgjithshme

1. Shqipëria përshëndet mbajtjen e Konferencës së Parë Ndërqeveritare. Shqipëria falënderon Bashkimin Evropian për mbështetjen e palëkundur dhe të vazhdueshme politike,

teknike dhe financiare ndaj Shqipërisë në rrugën e saj drejt BE-së. Ajo shpreh mirënjohjen për qëndrimin e qartë të BE-së për perspektivën evropiane të Shqipërisë dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor.

2. Hapja e negociatave të anëtarësimit në BE për Shqipërinë do të konsolidojë marrëdhëniet tashmë të forta mes BE-së dhe Shqipërisë nëpërmjet Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit. Procesi pasues do të jetë në interes dhe në dobi të Shqipërisë në planin afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë, ndërkohë që ajo përparon në mënyrë të qëndrueshme drejt harmonizimit dhe arritjes së standardeve të *acquis*-s të BE-së.

Një perspektivë e qartë dhe e bazuar në merita për anëtarësimin e plotë në BE për Shqipërinë është gjithashtu në interesin politik, ekonomik dhe në interesin e sigurisë të vetë Bashkimit Evropian. Në kohën e sfidave globale në rritje e të shumanshme, zgjerimi mbetet më shumë se kurrë një investim gjeostrategjik për një Evropë të qëndrueshme, të fortë dhe të bashkuar.

Agresioni ushtarak i pajustificuar dhe i paprovokuar i Rusisë kundër Ukrainës ka ndikim të madh mbi gjithë Kontinentin Evropian. Shqipëria ka bashkuar forcat dhe është plotësisht në linjë me të gjitha vendimet dhe deklaratat e Politikës së Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë të BE-së në dënimin e agresionit. Shqipëria zbaton plotësisht të gjitha paketat e sanksioneve. Shqipëria mbështet pa asnjë ekuivok vendimet e Këshillit të Sigurimit të OKB-së.

3. Anëtarësimi në Bashkimin Evropian është synimi politik dhe strategjik i Republikës së Shqipërisë dhe i sistemeve të saj ligjore, ekonomike dhe institucionale. Procesi i anëtarësimit në BE përfaqëson një mbështetje për demokratizimin e Shqipërisë, konsolidimin e institucioneve dhe të sundimit të ligjit dhe proceseve të vazhdueshme reformuese në vend. Shqipëria ka përmbushur të gjitha kriteret për hapjen e negociatave të anëtarësimit. Ajo është e vendosur të vazhdojë me këmbëngulje përpjekjet e saj në përmbushjen e të gjitha detyrimeve me synimin përfundimtar për t'u bërë shtet anëtar i BE-së.

4. Vendimi i Këshillit Evropian, i datës 26 mars 2020, për nisjen e negociatave të anëtarësimit me Republikën e Shqipërisë dhe vendimi për të thirrur Konferencën e parë Ndërqeveritare janë



momente kyçe në procesin e integritetit të Shqipërisë në BE.

5. Shqipëria pranon dhe angazhohet të zbatojë metodologjinë e re të negociatave të anëtarësimit, përfshirë qasjen e saj të grupimeve tematike dhe të stimujve përkatës.

Për të dinamizuar më tej procesin e negociatave dhe për të nxitur ndërthurjen e përpjekjeve përtej kapitujve individualë, Shqipëria mirëpret që kapitujt e negociatave të organizohen në grupe tematike që do të ndjekin tema të gjera, si qeverisja e mirë, tregu i brendshëm, konkurrenca ekonomike dhe ndërlidhshmëria etj.

6. Anëtarësimi në BE gëzon një mbështetje të plotë të padiskutueshme të të gjithë spektrit politik dhe të shumicës dërrmuese të popullsisë shqiptare. Shqipëria do të vijojë t'i komunikojë publikut përfitimet, si dhe domosdoshmërinë e procesit të anëtarësimit në BE, si zgjedhje strategjike dhe objektiv politik për të ardhmen e saj.

7. Shqipëria ndan thellësisht të njëjtat vlera me Bashkimin Evropian, siç përcaktohet në nenin 2, të Traktatit të Bashkimit Evropian. Shqipëria do të jetë një shtet anëtar aktiv dhe konstruktiv, veprimet e të cilit do të kontribuojnë në realizimin e parimeve dhe vlerave mbi të cilat bazohet BE-ja.

8. Shqipëria pranon plotësisht objektivat e përcaktuar në nenin 3 të Traktatit të Bashkimit Evropian. Shqipëria angazhohet për përafrimin e plotë me *acquis* të Bashkimit Evropian. Shqipëria pranon të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga *acquis*. Ajo do të marrë përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet e shteteve anëtare të BE-së.

9. Shqipëria ka dhe do të vazhdojë të dëshmojë përkushtimin e saj ndaj vlerave themelore të Bashkimit Evropian, respektimit të të drejtave themelore, duke përfshirë të drejtat e pakicave, demokracinë dhe shtetin e së drejtës. Shqipëria pranon se këto vlera themelore mbeten në thelb të procesit të anëtarësimit.

10. Zbatimi i reformës në drejtësi është themeli i reformave të sundimit të ligjit në Shqipëri. Është bërë punë e rëndësishme për ngritjen e organeve të reja të qeverisjes së pushtetit gjyqësor dhe funksionimin e plotë të tyre, për sigurimin e gjykatave plotësisht funksionale dhe për të siguruar një historik të qëndrueshëm të procesit të rivlerësimit kalimtar. Ka pasur një bashkëpunim të

ngushtë me Operacionin Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM). Reforma në drejtësi kontribuon në krijimin e një sistemi drejtësie të besueshëm, të drejtë, të pavarur, profesional, transparent, të përgjegjshëm dhe efikas, një sistem që do të gëzojë besimin e publikut, do të mbështesë zhvillimin e qëndrueshëm social-ekonomik të vendit dhe do të mundësojë integritetin e saj në familjen evropiane. Reforma në drejtësi do të krijojë kushtet, që trupa e gjyqtarëve dhe prokurorëve të arrijë standardet më të larta të integritetit, profesionalizmit dhe etikës.

11. Shqipëria është e vendosur të vazhdojë luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Lufta kundër korrupsionit është intensifikuar, duke forcuar koordinimin operacional dhe aftësitë monitoruese. Rezultate të mëtijshme të prekshme janë arritur në luftën kundër krimit të organizuar. Këto rezultate janë arritur edhe falë zbatimit të veprimeve dhe rekomandimeve të FATF-së dhe *Moneyval*-it si dhe përmes bashkëpunimit të zgjeruar me shtetet anëtare të BE-së. Shqipëria ka marrë pjesë në disa operacione policore ndërkombëtare që shënjestrojnë grupet e organizuara kriminale, duke çuar në arrestime dhe aktakuza të rëndësishme. Ajo ka zgjeruar dukshëm bashkëpunimin e saj të drejtpërdrejtë dhe efektiv me EUROJUST.

Arkitektura institucionale për ndjekjen penale dhe gjykimin e rasteve të korrupsionit dhe krimit të organizuar është plotësisht funksionale. Puna e Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe Prokurorisë së Posaçme të Strukturës së Posaçme Kundër Korrupsionit është bërë thelbësore për ndjekjen me më shumë forcë të luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Ka pasur arritje të rëndësishme në ndëshkimin e korrupsionit falë kuadrit ligjor të rishikuar dhe ndryshimeve kushtetuese, në lidhje me kufizimin e imunitetit të zyrtarëve publikë dhe gjyqtarëve, si dhe konfiskimin e pasurisë së tyre. Përpjekjet e Shqipërisë do të përforcojnë më tej historikun e përgjithshëm të hetimeve, ndjekjeve penale dhe dënimeve në lidhje me çështjet e krimit të organizuar dhe korrupsionit, në veçanti çështje të nivelit të lartë.

12. Shqipëria rritet angazhimin e saj për të marrë pjesë në të gjitha programet e Bashkimit Evropian, në strategjinë e BE-së për të luftuar krimin e organizuar, në përputhje me agjendat e



BE-së për drejtësinë dhe çështjet e brendshme për krimin e organizuar dhe korrupsionin. Kjo do të bëhet në përmbushje të planeve të veprimit të Komisionit, të cilat përcaktojnë prioritetet dhe rendisin masat që duhen marrë. Këta janë objektiva afatgjatë për Shqipërinë, me veprime konkrete që janë ndërmarrë nëpërmjet miratimit të strategjive, si dhe të planeve përkatëse të veprimit.

13. Identiteti kombëtar dhe kulturor i shqiptarëve është pjesë e trashëgimisë kulturore evropiane, që mbështetet në themelet e BE-së, bazuar në doktrinën “Të bashkuar në diversitet”. Përdorimi i gjuhës shqipe, si një nga gjuhët zyrtare të Bashkimit Evropian, do të shtojë zgjerimin e pasurisë kulturore dhe do të zhvillojë diversitetin që Bashkimi Evropian nxit. Masat e BE-së do të çojnë në ruajtjen e identitetit kombëtar të popullit shqiptar dhe të Republikës së Shqipërisë, si shtet i ardhshëm anëtar i BE-së.

14. Deri më sot, Shqipëria ka përkthyer nga gjuha angleze në gjuhën shqipe 42 000 faqe të *acquis*-s së BE-së dhe nga gjuha shqipe në gjuhën angleze rreth 2100 faqe të legjislacionit shqiptar që harmonizohet me *acquis*-n e BE-së. Shqipëria angazhohet të vazhdojë përkthimin e *acquis*-s së BE-së në gjuhën shqipe përpara anëtarësimit.

15. Shqipëria ka mbajtur në mënyrë të qëndrueshme linjëzimin 100% me deklaratat e BE-së dhe vendimet e Këshillit në Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë dhe do të vazhdojë ta bëjë këtë. Shqipëria është krenare të demonstrojë qëndrueshmërinë e plotë të këtij historiku, që kur Shqipëria u ftua në fillim të vitit 2004 të linjëzohej me vendimet përkatëse të Këshillit dhe deklaratat e përfaqësuesit të lartë në emër të BE-së, si pjesë e agjendës së Selanikut, me qëllim që të bashkërendonte me BE-në politikën e saj të jashtme dhe të sigurisë. Shqipëria angazhohet për të dhënë mbështetje të vazhdueshme dhe të qëndrueshme për qëndrimet e BE-së për çështjet ndërkombëtare, si pjesë e orientimit strategjik të politikës së jashtme dhe objektivit të saj për anëtarësim në BE. Shqipëria ka kontribuar, gjithashtu, në mënyrë aktive në misionet dhe operacionet e Politikës së Përbashkët të Sigurisë dhe Mbrojtjes, bazuar në marrëveshjen kuadër, të nënshkruar në vitin 2012. Ajo do të vazhdojë të ofrojë pjesëmarrjen e saj aktive.

16. Shqipëria ndan vlerat mbi të cilat mbështetet komuniteti euroatlantik. Aspirata e saj për anëtarësim në BE nuk mund të shkëputet nga vlerat dhe synimet e Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë të BE-së. Si një mbështetëse e fortë e multilateralizmit dhe të një zone evropiane të sigurisë, demokracisë dhe të të drejtave të njeriut, Shqipëria luan një rol të rëndësishëm si aleate e NATO-s që nga viti 2009. Shqipëria mbrojtëti të njëjtat parime dhe objektiva të përbashkët si kryesuesja e OSBE-së më 2020-ën. Si një anëtare jo e përhershme e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, për periudhën 2022–2023, Shqipëria do të kontribuojë në ruajtjen dhe forcimin e rendit shumëpalësh, të bazuar në rregulla, duke adresuar sfidat globale dhe duke promovuar paqen dhe sigurinë, në respekt të plotë të së drejtës ndërkombëtare, shtetit të së drejtës dhe të drejtave të njeriut, si themele për shoqëritë paqësore, të begata dhe të qëndrueshme.

17. Shqipëria angazhohet të mos nënshkruajë dhe të mos marrë pjesë në asnjë marrëdhënie kontraktuale ndërkombëtare, që nuk përputhet me vlerat dhe të drejtën evropiane.

18. Nëpërmjet anëtarësimit në BE, Shqipëria do të japë kontributin e saj në projektin evropian, ndër të tjera, edhe nëpërmjet vlerave të shtuara të pozicionit të saj gjeopolitik. Me daljet e saj në detin Adriatik dhe detin Jon, Shqipëria do të kontribuojë në ndërlidhjen e infrastrukturës transevropiane të transportit dhe energjisë dhe në forcimin e bashkëpunimit strategjik dhe operacional midis BE-së dhe Ballkanit Perëndimor për sigurinë dhe bashkëpunimin rajonal. Ky bashkëpunim është thelbësor për të trajtuar në mënyrë efektive kërcënimet tona të përbashkëta të sigurisë, si lufta kundër terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, migrimit të parregullt, kërcënimeve hibride dhe kibernetike, si dhe mbrojtja e investimeve strategjike.

19. Shqipëria ka qenë dhe mbetet një shtet laik gjatë gjithë historisë së shtetit shqiptar. Shoqëria shqiptare është multifetare dhe gëzon harmoni ndërfaqetare. Gjatë gjithë historisë së saj, Shqipëria nuk ka përjetuar kurrë ndonjë konflikt fetar. Harmonia ndërfaqetare ka qenë një faktor kryesor në mbrojtjen e pakicave në të kaluarën dhe do të jetë i tillë edhe në të ardhmen.

20. Minoritetet në Shqipëri gëzojnë të drejta të padiskutueshme. Personat që u përkasin



minoriteteve në Shqipëri ushtrojnë të drejtat dhe liritë e njeriut në barazi të plotë para ligjit. Ata kanë të drejtë të shprehin, pa ndalim apo detyrim, përkatësinë e tyre etnike, kulturore, fetare dhe gjuhësore. Gjatë negociatave për anëtarësimin në BE dhe më tej, Shqipëria do të vazhdojë të sigurojë gëzimin e plotë të të drejtave dhe lirive të tyre, në përputhje me Konventën Kuadër të Këshillit të Evropës për Mbrotjtjen e Pakicave Kombëtare.

21. Shqipëria është një vend me një pjesë të madhe të popullsisë që jeton jashtë vendit. Është bindja e Shqipërisë se anëtarësimi në BE do të përmirësojë shumë marrëdhëniet me vendet ku jetojnë shqiptarët. Shqipëria do të përfitojë shumë nga njohuritë e shqiptarëve që jetojnë jashtë në negociatat e saj të anëtarësimit.

22. Shqipëria jep një kontribut të rëndësishëm në procesin e bashkëpunimit rajonal në Ballkanin Perëndimor, duke u angazhuar plotësisht në këtë fushë edhe në kuadër të procesit të stabilizim-asociimit. Shqipëria merr pjesë aktive në të gjitha nismat rajonale dhe strukturat rajonale, si Procesi i Bashkëpunimit të Evropës Juglindore, Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal, Procesi i Berlinit, Ballkani i Hapur, Zona Ekonomike Rajonale etj. dhe punon në mënyrë proaktive për të çuar përpara arritjen e objektivave të tyre. Dy projekte të rëndësishme të bashkëpunimit rajonal në kuadër të Procesi të Berlinit, konkretisht, Fondi i Ballkanit Perëndimor dhe Zyra Rajonale e Bashkëpunimit Rinor, kanë selitë e tyre në Shqipëri. Duke mbështetur fuqimisht pjesëmarrjen e shoqërisë civile dhe të të rinjve në zbatimin e agjendës së bashkëpunimit rajonal në Ballkanin Perëndimor, Shqipëria nxit një klimë pajtimi dhe shkëmbimesh mes njerëzve që sjell gjithëpërfshirje, pjesëmarrje dhe angazhim qytetar të të rinjve dhe qytetarëve brenda vendeve të rajonit.

23. Shqipëria do të vazhdojë të forcojë marrëdhëniet dypalëshe me të gjitha vendet e rajonit, duke zhvilluar një dialog intensiv me ta dhe duke zbatuar mekanizmin e mbledhjeve të përbashkëta qeveritare që mundëson një bashkëpunim më efektiv.

24. Shqipëria është e përkushtuar ndaj zgjidhjes së mosmarrëveshjeve dypalëshe kufitare, nëse ka të tilla, në përputhje me parimet e zgjidhjeve paqësore të mosmarrëveshjeve të Kartës së OKB-

së dhe Konventës së OKB-së për të Drejtën e Detit, duke përfshirë, nëse është e nevojshme, edhe Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë.

25. Shqipëria angazhohet për sigurinë e kufijve të jashtëm të BE-së. Shqipëria ka qenë një partner i besueshëm i përpjekjeve evropiane gjatë dhe pas krizës së migracionit të vitit 2015 dhe trajtimit të luftëtarëve terroristë të huaj. Sfidat e terrorizmit dhe migracionit kanë treguar qartë se siguria e Ballkanit është siguria e të gjithë BE-së dhe anasjelltas. Shqipëria angazhohet për të luftuar në mënyrë efektive krimin e organizuar dhe terrorizmin, të përforcojë sigurinë, duke marrë pjesë në nismat e sigurisë, siç përcaktohet në Strategjinë e BE-së për Sigurinë e Bashkimit Evropian dhe agjendën kundër terrorizmit.

26. Shqipëria është e angazhuar të ndjekë shtyllat kryesore të Sistemit të Përbashkët Evropian të Azilit, Planin e Politikës së Komisionit për Azilin dhe programin legjislativ të reformuar, duke përfshirë Paktin e ri për Emigracionin dhe Azilin. Politikat e azilit do të sigurojnë rregullimin e duhur të emigrantëve të rregullt dhe të parregullt dhe rregullimin e duhur të pozitës së azilkërkuesve dhe refugjatëve, si dhe maksimizimin e përfitimeve nga migrimi. Shqipëria vazhdon të përafrojë legjislacionin e saj të migracionit me *acquis*-n e BE-së dhe konventat ndërkombëtare, ku ajo është palë. Ndërkohë që ajo ka një nivel shumë të lartë të ratifikimit të konventave ndërkombëtare në fushën e migracionit, vëmendje e vazhdueshme do t'i kushtohet forcimit të kapaciteteve institucionale, si mjete thelbësore për menaxhimin efektiv të migracionit.

27. Që nga hyrja në fuqi e liberalizimit të vizave në vitin 2010, qytetarët shqiptarë gëzojnë regjimin pa viza kur udhëtojnë në zonën Shengen të BE-së. Shqipëria ka dëshmuar të jetë një partnere e besueshme e Bashkimit Evropian, duke ruajtur që atëherë statusin e saj të privilegjuar. Shqipëria angazhohet të miratojë dhe të zbatojë *acquis*-n e *Schengen*-it.

28. Shqipëria mirëpret ndihmën financiare të ofruar nga Bashkimi Evropian si grante/fonde të paraanëtarësimit, si dhe në kuadër të pandemisë COVID-19 dhe, në veçanti, të Planit Ekonomik dhe Investimeve (PIE) për Ballkanin Perëndimor. Shqipëria pret me padurim zbatimin e shpejtë të PIE-së duke mbështetur rimëkëmbjen ekonomike



afatgjatë dhe të qëndrueshme, integrimin e suksesshëm rajonal dhe konvergjencën e përshpejtuar me BE-në. Për periudhën 2007–2020, në kuadër të Instrumentit të Asistencës së Paraaderimit (IPA), Shqipëria ka marrë forma të ndryshme ndihme financiare me qëllim zbatimin e reformave politike dhe ekonomike, ndërtimin e kapaciteteve institucionale dhe forcimin e bashkëpunimit, zhvillimit ekonomik dhe social.

Për këtë periudhë financiare, Shqipëria ka menaxhuar me sukses fondet IPA dhe IPARD. Asistenca është drejtuar drejt asistimit të përafrimit të legjislacionit shqiptar me *acquis*-n e BE-së për t'iu afruar negociatave të anëtarësimit me BE-në. Shqipëria ka marrë pjesë me sukses në programimin e IPA I & IPA II, për të njëjtën periudhë, me vlerë 1,15 miliardë euro. Përvoja e saj në përhithjen e fondeve IPA ka qenë pozitive, bazuar në përdorimin vjetor të fondeve IPA. Elementet e qasjes sektoriale janë përcaktuar dhe transferimi i përgjegjësisë tek autoritetet shqiptare për menaxhimin indirekt të fondeve IPA është dhënë pjesërisht përmes vendimit të KE-së të vitit 2014.

Shqipëria është plotësisht e përkushtuar për përdorimin sa më efektiv të programit IPA III, bazuar në rregulloren e re IPA.

29. Republika e Shqipërisë do të përpiqet të sigurojë që qëndrimi i saj politik, ekonomik dhe financiar, si shtet anëtar i BE-së, të jetë i matshëm me shtetet anëtare të BE-së me përmasa të ngjashme. Shqipëria është në dijeni se tregu i brendshëm është një gur themeli i Bashkimit Evropian. Vendi do të vazhdojë të harmonizojë legjislacionin e tij me *acquis communautaire* për lëvizjen e lirë të mallrave, krahut të punës, shërbimeve dhe kapitalit. Bashkimi Evropian është partneri më i madh tregtar i Shqipërisë. Vendi do të vazhdojë bisedimet me shërbimet e Komisionit Evropian për të qenë pjesë e Programit të Tregut të Vetëm të Bashkimit Evropian.

Procesi i integritimit

30. Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (MSA), ndërmjet BE-së dhe Shqipërisë, hyri në fuqi më 1 prill 2009. Sipas nenit 6 të MSA-së, që nga data 1 prill 2019, Shqipëria është plotësisht e asociuar me BE-në. MSA-ja është duke u mirëzbatuar. Zbatimi i plotë i dispozitave të saj nga të dyja palët do të përmirësojë përgatitjet e Shqipërisë për anëtarësim

të plotë dhe do t'i korrespondojë evoluimit të marrëdhënieve Shqipëri-BE. Shqipëria angazhohet të sigurojë më tej përputhshmërinë me MSA-në, si një element i rëndësishëm në procesin e anëtarësimit në BE.

31. Me nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, Shqipëria është angazhuar të përafrojë gradualisht legjislacionin e saj me *acquis*-n e BE-së dhe ta zbatojë atë në mënyrë të qëndrueshme. Hartimi i një plani për përafrimin e *acquis* ka filluar në muajin shtator 2007, me miratimin e Planit Kombëtar për Zbatimin e MSA-së (PKZMSA) 2007–2012. Plan kombëtar, në formatin aktual, u zbatua për periudhën 2014–2020. Me vendimet respektive të Këshillit të Ministrave Shqipëria ka miratuar Planin Kombëtar të Integritimit Evropian (PKIE) 2021–2023 dhe 2022–2024.

32. Shqipëria pranon zbatimin e *acquis*-s të BE-së në rendin juridik shqiptar. Shqipëria ka vazhduar të harmonizojë legjislacionin dhe kapacitetet e saj me standardet evropiane. Është bërë përparim në një sërë fushash. Shqipëria angazhohet për përpjekje thelbësore dhe të qëndrueshme që do të jenë të nevojshme, në lidhje me përgatitjet e përgjithshme për miratimin dhe zbatimin e *acquis*-s të BE-së, duke përfshirë përpjekjet e intensifikuara për të siguruar forcimin e kapaciteteve administrative dhe për të pasur strukturë të përshtatshme institucionale përpara anëtarësimit.

Përmbajtja e negociatave

33. Në muajin mars 2020, Këshilli mori vendimin për hapjen e negociatave të anëtarësimit me Shqipërinë. Në përgjithësi, Shqipëria ka rritur përpjekjet e saj dhe ka dhënë rezultate të mëtijshme të prekshme dhe të qëndrueshme për të gjitha kërkesat dhe prioritetet e rëndësishme të identifikuar në konkluzionet e Këshillit të marsit 2020. Shqipëria ka plotësuar të gjitha kushtet për Konferencën e Parë Ndërqeveritare. Shqipëria mirëpret miratimin e kuadrit negociator nga Këshilli dhe organizimin e Konferencës së Parë Ndërqeveritare.

34. Shqipëria mirëpret fillimin e procesit të negociatave, bazuar në metodologjinë e re të zgjerimit, të miratuar nga Këshilli Evropian, në mars 2020, dhe siç është parashikuar në kuadrin negociator për Shqipërinë. Shqipëria miraton metodologjinë e re, me synimin për ta bërë



procesin e anëtarësimit më të parashikueshëm, më të besueshëm dhe dinamik dhe me një drejtim politik më të fortë. Shqipëria nuk kërkon të tërhiqet nga asnjë politikë e BE-së, as nuk kërkon derogime të përhershme në lidhje me *acquis*-in e BE-së, aktualisht në fuqi.

Gjatë negociatave të anëtarësimit Shqipëria mund të kërkojë periudha kalimtare për ata sektorë ku, në momentin e anëtarësimit të saj në Bashkimin Evropian, nuk do të jetë arritur ende një nivel i mjaftueshëm përgatitjeje për harmonizim dhe zbatim të plotë. Këto periudha do të jenë me kohëzgjatje dhe fushëveprim të kufizuar. Plane me faza të përcaktuara qartë për përmbushjen e detyrimeve të anëtarësimit do të shoqërojnë kërkesat për periudha kalimtare. Objektivi i Shqipërisë është aderimi sa më i shpejtë i mundshëm me marrëveshjet përkatëse kalimtare, që kërkojnë për të siguruar integritet normal në politikat e BE-së.

Shqipëria pret që negociatat të fokusohen në çështjet kryesore të mëposhtme:

- Objektivat e Shqipërisë për negociatat e anëtarësimit janë një proces i rregullt integrimi në të katërta liritë dhe përdorimi efikas i përgatitjeve për zgjerimin në planin afatshkurtër dhe afatgjatë. Bazuar në metodologjinë e re të procesit të negociatave, Shqipëria do të synojë futjen graduale në programet dhe politikat e BE-së, pasi të jetë e përgatitur për ta bërë këtë, përpara anëtarësimit.

- Katër liritë që përbëjnë tregun e vetëm duhet të mbizotërojnë në shtrirjen më të gjerë të mundshme. Shqipëria është e gatshme të rrisë hapat e nevojshëm, përfshirë edhe në nivel rajonal, nëpërmjet krijimit të zonës ekonomike rajonale, si çështje me përparësi. Kjo përfshin dhe përcaktimin e masave kalimtare për këtë qëllim.

35. Shqipëria ndan plotësisht të njëjtët objektiva të Bashkimit Ekonomik dhe Monetar. Megjithatë nga anëtarësimi si shtet anëtar, Shqipëria do të shmangë pjesëmarrjen e saj në Eurozonë, ajo pranon detyrimet që rrjedhin nga BEM-ja. Shqipëria synon të marrë pjesë në Eurozonë sa më shpejt që të jetë e mundur pas anëtarësimit të saj.

36. Tregjet dhe sistemi financiar në Shqipëri kanë evoluar gjatë dekadave të fundit. Këto janë mbështetur nga prania e bankave, institucioneve financiare të BE-së dhe modernizimit të infrastrukturës rregullatore/mbikëqyrëse, sipas

standardeve të BE-së. Tregjet kanë funksionuar normalisht. Sistemi financiar ka treguar elasticitet ndaj goditjeve të brendshme dhe nga jashtë. Ndërkohë që Shqipëria do të përparojë në rrugën e saj të anëtarësimit në BE, vendi do të insistoje për modernizimin e mëtejshëm të infrastrukturës financiare, për akses më të mirë në shërbimet financiare dhe për rritjen e kontributit të sistemit financiar në rritjen ekonomike.

37. Në kuadër të procesit të anëtarësimit, objektivi kryesor i politikës ekonomike të Shqipërisë është forcimi i konkurrueshmërisë së ekonomisë së saj, me synim forcimin e kapaciteteve për të përballuar presionin konkurrues të tregut të përbashkët evropian dhe uljen e papunësisë. Shqipëria pret që rezultati i negociatave të sigurojë kushte për një mjedis financiar dhe makroekonomik të qëndrueshëm dhe një ekonomi tregu konkurruese me sektorë të fortë industrialë, bujqësorë dhe turistikë, përmes inovacionit.

38. Shqipëria e identifikon turizmin si një nga ekosistemet industriale, ku mund të merren masa të mëtejshme, bazuar në strategjinë 2019–2023 në fuqi, në përputhje me objektivat e BE-së për dekadën e ardhshme. Kjo do të kontribuonte në cilësinë më të mirë të jetës, zhvillimin, përmirësimin dhe promovimin e produkteve dhe shërbimeve turistike duke pasur parasysh tri dimensionet e qëndrueshmërisë: ekonomike, sociale dhe mjedisore. Këto masa përfshijnë: përmirësimin e efikasitetit të burimeve, menaxhimin e mbetjeve dhe ujërave për të minimizuar ndikimin mjedisor, duke respektuar trashëgiminë kulturore, mundësitë e reja të punësimit, ndërtimin dhe modernizimin e qëndrueshëm të turizmit dhe infrastrukturës publike, transportin, transformimin digjital, telekomunikacionin, si dhe produktet dhe shërbimet financiare novatore. Sektori i turizmit në Shqipëri ka një potencial të madh, duke krijuar pole dhe industri të reja zhvillimi: do të punohet për konsolidimin e ofertës turistike, rritjen e vlerës së shtuar dhe ndikimin e sektorit në ekonomi dhe punësim; zhvillimin e produkteve dhe shërbimeve të reja në turizëm, përmirësimin e cilësisë së tyre, imazhit të vendit dhe promovimit të produkteve vendëse.

39. Shqipëria do të negociojë pranimin e saj në BE, duke marrë parasysh nevojën për të



përmirësuar kohezionin social dhe ekonomik dhe reduktuar pabarazitë rajonale përmes zhvillimit të rajoneve të pazhvilluara, të cilat janë edhe objektivat e politikës së kohezionit të Bashkimit Evropian. Anëtarësimi do t'i ofrojë Shqipërisë një mundësi për të marrë një shtysë të mëtijshme për përpjekjet e saj për modernizimin dhe për të kontribuar njëkohësisht në forcimin e pozicionit global të BE-së.

40. Shqipëria e konsideron bujqësinë dhe zhvillimin rural si një sektor të rëndësishëm ekonomik me ndikim të drejtpërdrejtë në mjedis, rritjen e gjelbër, sigurinë ushqimore, avancimet teknologjike. Shqipëria e konsideron të domosdoshme ngritjen e standardeve të politikës së saj bujqësore, jo vetëm në një nivel që plotëson nevojat e tregut në Shqipëri dhe BE, por edhe për të garantuar cilësinë e produkteve, ekuilibrin e duhur midis konsumit dhe prodhimit dhe rritjen e përfitimeve të sektorit. Shqipëria ka bërë përpjekje të shtuara, falë fondeve të BE-së nëpërmjet programit IPARD II, për të siguruar një integritet të plotë dhe të shpejtë të bujqësisë së Shqipërisë në Politikën e Përbashkët Bujqësore.

41. Qeveria shqiptare është e vendosur të transformojë ekonominë shqiptare nga një ekonomi e varur nga importi, e bazuar në konsum, dhe informale në një ekonomi që bazohet në krijimin e qëndrueshëm të vendeve të punës dhe rritjen e produktivitetit të saj. Ajo ka njohur gjerësisht nevojën për të trajtuar sistematikisht punësimin, duke riorientuar sistemin e arsimit dhe trajnimit drejt nevojave të tregut të punës dhe duke modernizuar dhe zgjeruar shtrirjen e shërbimeve të punësimit. Shqipëria do të ketë prioritet përfshirjen sociale dhe ekonomike të grupeve në nevojë, domethënë të rinjve, grave, personave me aftësi të kufizuara, pakicave etnike, përcaktimit të një agjende sociale dhe përfshirjes së partnerëve socialë në zbatimin e saj.

42. Rritja ekonomike nëpërmjet rritjes së konkurrueshmërisë dhe inovacionit është një nga prioritetet për të ardhmen dhe premisa për zhvillimin e qëndrueshëm social-ekonomik të Shqipërisë. Zhvillimi i sipërmarrjes dhe i inovacionit u përgjigjet nevojave të vendit për rritje ekonomike, zhvillim të qëndrueshëm sociokonomik, investime në kapitalin njerëzor, zhvillimin e SME-ve dhe promovimin e inovacionit në teknologji, shkencë dhe inovacion.

43. Shqipëria është e angazhuar për një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit. Shqipëria ka bërë hapa gjigantë duke zbatuar *acquis*-n e BE-së në këtë fushë të gjerë. Megjithatë, do të kërkohen masat kalimtare për të harmonizuar këtë angazhim me nevojën për të respektuar disa dispozita të *acquis*-s që kërkojnë investime të konsiderueshme.

44. Shqipëria beson fort në mbrojtjen e burimeve natyrore, në veçanti të peshkimit. Kur Shqipëria të bëhet anëtare e BE-së, deti Adriatik dhe deti Jon do të jenë detet e brendshme të BE-së. Prandaj këto dy territore detare të Shqipërisë do të rregullohen ekskluzivisht nga ligjet dhe rregulloret evropiane.

45. Në lidhje me sektorin e transportit, Shqipëria do të angazhohet në aktivitetet e Komunitetit të Transportit dhe miratimin e planeve të veprimit me hapa të detajuar për të përmirësuar, në veçanti, sigurinë rrugore, hekurudhat, transportin ujor dhe multimodal. Puna ka avancuar për zgjerimin e korsive/korridoreve të gjelbra me shtetet anëtare të BE-së. Është miratuar legjislacioni për ngritjen e agjencisë hekurudhore. Në sektorin e energjisë, Shqipëria do të punojë për liberalizimin e tregut të saj të energjisë elektrike dhe do të finalizojë ngritjen e bursës së saj të energjisë për të garantuar integritetin me vendet fqinje.

Procesi i negociatave:

46. Me miratimin e konkluzioneve të Këshillit Evropian të Selanikut, të vitit 2003, Shqipëria pranon dhe mbështet plotësisht parimin e progresit individual, të bazuar në meritat e veta, si bazë e procesit të anëtarësimit.

47. Duke pranuar se progresi në grupimin “Thelbësoret” do të përcaktojë ritmin e të gjitha negociatave, Shqipëria do t'i kushtojë vëmendje të veçantë përafrimit të të gjithë këtij grupimi me *acquis*-n dhe standardet ndërkombëtare, për të krijuar një historik të qëndrueshëm të zbatimit të tyre. Shqipëria pranon se mekanizmi i prezantuar nga metodologjia e re e zgjerimit në mars 2020, nëpërmjet strukturës së saj të grupimeve, mund të favorizojë vendet që përmbushin kriteret.

48. Synimi i negociatave të anëtarësimit është anëtarësimi i Shqipërisë në Bashkimin Evropian me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga anëtarësimi. Shqipëria pret që negociatat të ecin pa probleme dhe në mirëbesim. Rezultatet e tyre duhet të jenë reciprokisht të dobishme, si për



Shqipërinë ashtu edhe për BE-në. Anëtarësimi i Shqipërisë në Bashkimin Evropian do të mbrojë interesat jetikë të qytetarëve të saj.

49. Republika e Shqipërisë ka një pozicion fillestar të favorshëm në negociatat e anëtarësimit, sepse që në vitin 2007 ka filluar përafrimin e organizuar të legjislacionit të saj me *acquis*-n e BE-së. Në përmbushjen e detyrimeve ndaj MSA-së, zbatimit të PKIE-së për miratimin e *acquis*-s të BE-së, Shqipëria ka bërë progres në përafrimin e legjislacionit të saj me *acquis*-n e BE-së. Shqipëria është e gatshme të përafrojë legjislacionin e saj me *acquis*-n e BE-së dhe ta zbatojë atë në kohë dhe me efikasitet.

50. E ndërgjegjshme për sfidat e ardhshme, qeveria e Shqipërisë është angazhuar për të ofruar kapacitete të përshtatshme administrative në të gjitha fushat që lidhen me procesin e integritetit evropian. Gjatë viteve të fundit është krijuar dhe është bërë funksional kuadri i nevojshëm institucional. Vendimi nr.749, datë 19.12.2018, i Këshillit të Ministrave, përcaktoi strukturën shtetërore që është përgjegjëse për negocimin dhe përfundimin e Traktatit të Anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë me Bashkimin Evropian. Grupet e Punës Ndërinstitucionale u krijuan sipas urdhrit nr. 94, datë 20.5.2019, të Kryeministrit dhe vendimi nr. 422, datë 6.5.2020, i Këshillit të Ministrave, emëroi Kryenegociatorin dhe Grupin Negociator. Shqipëria do të përmirësojë më tej strukturat integruese për të përmbushur të gjitha kërkesat e negociatave të anëtarësimit. Delegacioni shtetëror do të përfaqësojë Republikën e Shqipërisë në konferencat ndërqeveritare Shqipëri – Bashkimi Evropian dhe do të jetë përgjegjës për dialogun politik dhe negociatat me institucionet e Bashkimit Evropian.

51. Kuvendi i Shqipërisë, gjatë negociatave të anëtarësimit në BE, do të jetë forumi i debatit politik mbi synimet strategjike dhe politike të integritetit në BE dhe do të kryejë përafrim të rëndësishëm ligjor; monitorim dhe shqyrtim; informim; detyra të bashkëpunimit ndërkombëtar dhe ndërparlamentar. Gjatë negociatave të anëtarësimit, qeveria e Shqipërisë do të vazhdojë të raportojë periodikisht për fazën e integritetit të vendit në BE në Kuvendin e Shqipërisë dhe në Këshillin Kombëtar për Integrimin Evropian.

52. Dialogu me shoqërinë civile dhe bashkëpunimi kulturor do të vazhdojnë dhe do të

forcohen më tej me synimin për të siguruar mbështetjen e qytetarëve për procesin e anëtarësimit. Qeveria e Shqipërisë ka krijuar tashmë një Platformë të Partneritetit të Integritetit Evropian për të informuar, konsultuar, komunikuar dhe angazhuar shoqërinë civile, palët e interesuara, sindikatat, akademinë dhe organet e vetëqeverisjes vendore në procesin e negociatave të anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

53. Shqipëria është e vetëdijshme se kohëzgjatja dhe ritmi i negociatave do të varen nga aftësia e saj për të përmbushur detyrimet e anëtarësimit në BE.

54. Traktati i anëtarësimit do të miratohet në përputhje me dispozitat kushtetuese në Shqipëri në kohën e anëtarësimit.

SHTOJCA 1 PERIUDHA TRANZITORE

	KAPITUJT	PERIUDHA
1	Bujqësia dhe zhvillimi rural	
2	Mbrojtja e mjedisit dhe ndryshimet klimatike	
3	Peshkimi	
4	Industria	
5	Politika rajonale	
6	Transporti	

COUNCIL OF MINISTERS THE FIRST INTERGOVERNMENTAL CONFERENCE ON THE ACCESSION OF THE REPUBLIC OF ALBANIA TO THE EUROPEAN UNION OPENING STATEMENT OF REPUBLIC OF ALBANIA GENERAL POSITION Brussels, _____.____.202_

General Remarks

